

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**ZËDHËNËSI**

---

Tiranë, më 05.01.2014

*Njoftim për Shtyp*

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI**  
**ANËTARËT E BORDIT TË DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE**  
**TË PANDARA DHE JURISTIN E KOMUNËS ZALL HERR, QARKU I TIRANËS**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 578/1, datë 01.07.2013, ka ushtruar auditim në **komunën Zall- Herr**, Qarku i Tiranës për veprimtarinë e ushtruar në periudhën Janar 2011-Dhjetor 2012. Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh, për të cilat u dërguan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kallëzim penal tre nënpunës të komunës Zall Herr: H.B me detyrë përgjegjës i zyrës juridike, F.L topograf dhe H.U specialist i bujqësisë, pyjeve dhe kullotave, si dhe S.B specialist në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë dhe N.K, punonjës i Këshillit të Qarkut Tiranë, të cilët kanë kryer detyrën e anëtarit të Bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara në komunën Zall Herr, me akuzën e shpërdorimit të detyrës për:

- **Mos zbatimin e procedurave ligjore të dhënies me qira të tokave të pandara.** Bordi i ndarjes së tokave të pandara të Komunës Zall-Herr, ka dhënë me qira toka të pandara dhe ka lidhur **188 kontrata për një sipërfaqe prej 360 ha** në periudhën 2010-2012, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dukë tjetërsuar pronën e komunës pa u zbatuar procedurat ligjore të caktuara.

- Dhënie me qira të tokave bujqësore **pa ju transferuar me VKM komunës Zall-Herr, pra pa i pasur ato në pronësi dhe pa i regjistruar në ZVRPP**, pasuri të cilat nuk figurojnë as në listat paraprake të miratuar me VKM nr. 915, datë 29.12.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zall-Herr, të Qarkut të Tiranës dhe VKM nr. 254, datë 12.03.2009 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Zall-Herr,të Qarkut,Tiranës".**Dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara është kryer pa i pasur ato në pronësi**, duke vepruar në kundërshtim me neni 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

- Në 106 kontrata e lidhura me qiramarrësit për sipërfaqe prej 160 ha, kontratat të cilat **nuk janë TIP** (sipas formatit ligjor) edhe pse janë dhënë me një afat të gjatë prej 99 vjetësh, e për këtë nuk janë vendosur sanksione dhe nuk është llogaritur kamat vonesa. Këto veprime bien në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip" të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore" dhe Udhëzimin e KM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara",ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara". – **Mosndjekje të zbatimit të kushteve të kontratave të lidhura për dhënien me qira për tokat bujqësore të pandara për 54 persona një sipërfaqe prej 77 ha tokë.** Për pasojë është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e komunës Zall-Herr në vlerën prej **1,749,241 lekë**, nga e cila **20 persona** kanë shkelur kontratat me një dëm ekonomik në vlerën 1,590,747 lekë.

- **Janë pranuar dhe depozituar në Komunë, 188 kontrata** të qirave të tokave të pandara, të cilat nuk ishin të regjistruar në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), Tiranë dhe **janë absolutisht të pavlefshme**, pasi janë lidhur në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar me neni 32 të ligjit nr. 9208, datë 18.3.2004.

- **Dhënia me qira të tokave bujqësore të pandara** është bërë për një afat **prej 99 vjetësh**, ndërkohë nga 188 kontratat e hartuara dhe lidhura, vetëm 19 prej tyre janë noterizuar, duke vepruar në kundërshtim me neni 826 të Kodit Civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

- Nuk janë të plotësuar me dokumentet ligjore dosjet e krijuara, pra mungojnë 357 dokumente.

- Nuk janë zbatuar procedurat ligjore në dhënien me qira për aktivitet biznesi 9 personave për aktivitet biznesi në periudhën në vitin 2008-2012, për sipërfaqen **45.2 ha, si dhe kontratat janë nënshkruar pa noter dhe mungojnë sanksionet ligjore**. Dhënia me qira **për 9 pasuritë është bërë pa i pasur ato në pronësi**, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore". Nuk janë miratuar më parë në Këshillin e Komunës Zall-Herr, në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004. Janë lidhur kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, **9 personave** janë hartuar dhe lidhur për një afat **prej 30 vjetësh**. Nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore tarifa e qirasë së tokës bujqësore të pafrytshme, për 1 m<sup>2</sup>/vit.

Për të gjitha veprimet e mësipërme, KLSH i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzim penal, për shpërdorim detyre për personat e sipërpërmendur.

KLSH ka kërkuar fillimin e procedurave ligjore për dhënien e masës disiplinore, "**Largim nga detyra**", për këta punonjës, si dhe marrjen e masave të tjera disiplinore për 14 (katërmbëdhjetë) nëpunës të tjerë të këtij institucioni.

Gjithashtu, KLSH i ka kërkuar Ministrin të Drejtësisë fillimin e procedurave ligjore për heqjen e licencës së noterit publik për noterët E.S. dhe Sh.Sh.